




COVID-19, Përmbledhje mbi Masat e Ndërmarra dhe Aktet Përkatëse

24 Mars 2020

Përmbledhje përgatitur nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Përmbledhje

I.	HYRJE.....	2
II.	PLANI FINANCIAR PËR PËRBALLIMIN E PASOJAVE TË COVID-19	2
III.	KUADRI LIGJOR/NËNLIGJOR DHE MASAT E MARRA	3
	TË PËRGJITHSHME.....	3
	MASA ADMINISTRATIVE/SANKSIONE	6
	KONTRATAT E PASTRIMIT DHE TRANSPORTIT PUBLIK.....	10
	KOHËZGJATJA E PUNËS NË INSTITUCIONET SHTETËRORE	10
	ORARET E LËVIZJES DHE KUFIZIME TË TJERA.....	11
IV.	VENDIME DHE NJOFTIME TË TJERA TË RËNDËSISHME NGA ORGANET MBIKËQYRËSE DHE RREGULLATORE	14

I. HYRJE

Nisur nga situata e krijuar në vend nga COVID-19 që prej datës 9 Mars 2020, në vend janë ndërmarrë një sërë masash të cilat kanë ardhur duke u përshkallëzuar. Dinamika e akteve ligjore dhe nënligjore me të cilat janë marrë këto masa me natyrë shtrënguese/kufizuese në funksion të kontrollit të situatës së epidemisë dhe uljes së numrit të të infektuarve nga COVID-19, ka qenë shumë e madhe. Së fundmi, Qeveria publikoi edhe një plan masash në kuadër të mbështetjes financiare për individët dhe bizneset. Në këtë përmbledhje e cila nuk synon të jetë shteruese, jepet informacion mbi aktet ligjore dhe nënligjore më kryesore të miratuara deri më tani dhe të zbatueshme gjatë kohëzgjatjes së COVID-19, si edhe të masave dhe detyrimeve të adoptuara me to.

Informacioni në këtë përmbledhje është i përditësuar deri më **24.03.2020** dhe synon t'u vijë në ndihmë të gjithë bizneseve apo punonjësve të tyre dhe të gjithë partnerëve të Këshillit të Investimeve dhe Sekretariatit, si edhe të shërbejë modestisht në rritjen e ndërgjegjësimit për zbatimin vullnetar të masave dhe të detyrimeve të vendosura.

Informacioni për këto masa është bërë me dije rast pas rasti për publikun, individët dhe bizneset nga media e shkruar dhe elektronike, si edhe në faqet zyrtare të institucioneve të administratës publike (si p.sh.: [Ministria e Financave dhe Ekonomisë](#), [Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale](#), [Qendra e Botimeve Zyrtare-QBZ](#)), të cilat sugjerohet të konsultohen kohë pas kohe për informacion të përditësuar nisur nga zhvillimet shumë dinamike.

II. PLANI FINANCIAR PËR PËRBALLIMIN E PASOJAVE TË COVID-19

- Plan i financiar u lançua më 19.03.2020 dhe ka hyrë në fuqi që më 21.03.2020 si Akti Normativ Nr. 6 datë 21.03.2020 [Për Disa Ndryshime dhe Shtesa Në Ligjin Nr.88/2019, "Për Buxhetin e Vitit 2020"](#). Ky akt normativ do të shoqërohet nga udhëzimet përkatëse për zbatimin e tij.
- Plan i përmban 7 pika të mëposhtme:
 - (1) **2.5 miliardë lekë, ose 25 milionë dollarë** në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë, për pajisje e materiale mjekësore apo mbështetje të stafeve mjekësore;

- (2) **10 miliardë lekë, ose 100 milionë dollarë**, përmes instrumentit të një **garancie sovrane** për kompanitë që kanë vështirësi objektive për të paguar pagat e punonjësve.
- (3) **6.5 miliardë lekë, ose 65 milionë dollarë për nevojat më imediate:**
 - a) Për shtresat më në nevojë;
 - b) Për biznesin e vogël;
 - c) Për papunësinë e mundshme për shkak të luftës.
- (4) **2 miliardë lekë, ose 20 milionë dollarë**, që vihet në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes, për **Operacionin Humanitar**.
- (5) **1 miliardë lekë, ose 10 milionë dollarë, si fond rezervë** për Këshillin e Ministrave, për çdo urgjencë të paparashikueshme.
- (6) **Fshirja përgjithmonë e kamatvonesave për debitorët aktivë** që kanë konsum energjie sot, familjarë apo biznes i vogël, me efekt financiar deri në 15 miliardë lekë, ose 150 milionë dollarë. Nga kjo masë do të përfitojnë 211 mijë e 24 abonentë.
- (7) **Riskedulimi në 6 mujorin e dytë të vitit 2020 dhe në vazhdim, i tatim-fitimit për të gjithë biznesin deri në fashën nga 2 deri në 14 milionë lekë.** Shtyrja e dorëzimit të bilanceve për një periudhë deri në 1 qershor të këtij viti për bizneset që dorëzojnë bilancet në QKB online ose drejtëpërdrejtë.

Për më shumë informacion vizitoni lidhjet e mëposhtme:

- <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/45/2c644067-b09f-4c65-adb5-aedf5fbc647f>
- <https://kryeministria.al/newsroom/plani-financiar-per-perballimin-e-pasojave-te-covid-19/>
- <http://www.financa.gov.al/njoftim-per-shtyp-2/>

III. KUADRI LIGJOR/NËNLIGJOR DHE MASAT E MARRA

TË PËRGJITHSHME

- 1. LIGJI Nr.15/2016 “PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E INFEKSIONEVE DHE SËMUNDJEVE INFEKTIVE”- Fletore Zyrtare Nr. 46/2016**

- Ky ligj përcakton përgjegjësitë dhe rolin e shërbimeve shëndetësore, shërbimeve të shëndetit publik, si dhe aktorëve të tjerë të të gjitha niveleve, publike e jopublike, në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësiave për sëmundjet infektive dhe ngjarjet me rëndësi për shëndetin publik.
- Disa nga **parimet** kryesore për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive janë si më poshtë:
 - (1) parandalimi i sëmundjeve ngjitëse në territorin e Republikës së Shqipërisë është i detyrueshëm;
 - (2) parandalimi dhe luftimi i infeksioneve dhe sëmundjeve infektive ofrohet pa asnjë lloj diskriminimi;
 - (3) parandalimi dhe luftimi i infeksioneve dhe sëmundjeve infektive ofrohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - (4) parandalimi dhe luftimi i sëmundjeve infektive me karakter epidemik, sipas listës të përgatitur nga Shërbimi Kombëtar i Inteligjencës Epidemike ofrohet falas për çdo person;
 - (5) mbrojtja nga sëmundjet infektive bëhet sipas një planifikimi, programimi, organizimi, zbatimi të masave për parandalimin, diagnozën, trajtimin, luftimin, zhdukjen e sëmundjeve infektive dhe sigurimin e mjeteve e infrastrukturës së domosdoshme për mbrojtjen shëndetësore ndaj tyre;
 - (6) çdo person ka të drejtë të përfitojë nga masat për mbrojtjen nga sëmundjet infektive;
 - (7) çdo person i sëmurë nga sëmundjet infektive me karakter epidemik ka të drejtën dhe detyrimin të mjekohet falas në çdo institucion shëndetësor publik apo jopublik;
 - (8) çdo individ, çdo person fizik ose juridik dhe çdo institucion ka për detyrë që të zbatojë masat e përcaktuara dhe të urdhëruara nga organet kompetente, për mbrojtjen nga sëmundjet infektive;
 - (9) çdo përpjekje për kontrollin, eliminimin dhe zhdukjen e sëmundjeve infektive duhet të ndërpresë zinxhirin e infeksionit, duke u fokusuar në kontrollin e agentit infektues, burimin e infeksionit, mënyrën e transmetimit dhe strehuesin përkatës.
- **Njoftimi dhe raportimi i sëmundjeve infektive** - çdo institucion publik apo jopublik raporton tek organet përkatëse, të përcaktuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë për:
 - (1) çdo infeksion, i cili, sipas tij, paraqet apo mund të paraqesë dëm të rëndësishëm për shëndetin e njeriut;
 - (2) çdo ngjarje jo të zakonshme apo sindroma, e cila apo të cilat, sipas tij, paraqesin apo mund të paraqesin dëm të rëndësishëm për shëndetin e njeriut;
 - (3) çdo sëmundje apo infeksion të dyshuar apo të konfirmuar në personat e vdekur;
 - (4) agentët infektues, të cilët janë gjetur te mostrat humane të ekzaminuara prej tyre.

- Ligji parashikon **masat e veçanta** që mund të zbatohen për parandalimin e sëmundjeve infektive. Më kryesoret janë:
 - (1) zbulimi në kohë i burimit të infeksionit dhe rrugëve të marrjes e përhapjes së tij;
 - (2) survejanca epidemiologjike dhe njoftimi i hershëm dhe i shpejtë;
 - (3) izolimi dhe karantina;
 - (4) transportimi i sigurt;
 - (5) diagnoza e saktë dhe në kohë reale mikro-biologjike;
 - (6) trajtimi dhe shërimi i personave të sëmurë;
 - (7) gjurmimi i kontakteve me persona të infektuar apo të sëmurë;
 - (8) kufizimin ose ndalimin e udhëtimeve në vendin ku është përhapur epidemia nga këto sëmundje;
 - (9) kufizimin ose ndalimin e qarkullimit në rajonet e infektuara ose të rrezikuara;
 - (10) kufizimin ose ndalimin e qarkullimit të llojeve të ndryshme të mallrave dhe produkteve;
 - (11) marrjen pjesë, në mënyrë të detyrueshme, të institucioneve shëndetësore dhe institucioneve të tjera, si dhe të qytetarëve në luftimin e sëmundjes ngjitëse, shfrytëzimin e objekteve dhe mjeteve të transportit.
- **Strukturat përgjegjëse** për kontrollin e sëmundjeve infektive janë:
 - (1) Instituti i Shëndetit Publik
 - (2) Shërbimi Kombëtar i Inteligjencës Epidemike
 - (3) Shërbimi Kombëtar i Sëmundjeve Infektive

Për përmbajtjen e plotë të aktit [kliko këtu](#).

2. **AKT NORMATIV Nr.2, DATË 11.3.2020 PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.15/2016, “PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E INFEKSIONEVE DHE SËMUNDJEVE INFEKTIVE”- Fletore Zyrtare Nr. 34/2020**

Me anë të këtij akti normativ u bënë disa shtesa dhe ndryshime në ligjin e mësipërm me anë të të cilave u parashikuan:

- (1) **vetëkarantimi si masë e veçantë shtesë** për parandalimin e sëmundjeve infektive;

- (2) **angazhohen Policia e Shtetit dhe Forcat e Armatosura**, në ndihmë të saj për të siguruar zbatimin e masave parandaluese;
- (3) **ashpërsimi i masave administrative** të zbatueshme nga ana e institucioneve përkatëse.

Për përmbajtjen e plotë të aktit kliko [këtu](#).

MASA ADMINISTRATIVE/SANKSIONE

3. AKT NORMATIV Nr. 3, DATË 15.3.2020 PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUdhËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19- Fletore Zyrtare Nr. 37/2020

- Ky akt normativ ka për qëllim përcaktimin dhe forcimin e zbatimit të rregullave, të vendimeve, të urdhrave dhe të udhëzimeve të nxjerra nga organet kompetente, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Akti normativ ka karakter të përkohshëm dhe zbatohet për atë kohë sa zgjat periudha e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.
- Të drejtën e dhënies së masave administrative të këtij akti normativ, e ka organi kompetent sipas fushës së përgjegjësisë dhe, në çdo rast, nga Policia e Shtetit.
- Gjambat e dhëna, sipas këtij akti normativ, përbëjnë titull ekzekutiv dhe derdhen 100% në buxhetin e shtetit.
- Masat administrative të përcaktuara nga Akti Normativ kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjit 15/2016 lidhur me masat administrative.
- Disa nga masat administrative të parashikuara janë:
 - (1) Subjektet që eksportojnë barna dhe pajisje mjekësore nga Republika e Shqipërisë, pa autorizim të posaçëm të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për kryerjen e këtij aktiviteti, dënohen me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë dhe iu sekuestrohet e gjithë sasia e barnave/pajisjeve mjekësore. Në rast përsëritjeje, masave të mësipërme iu shtohet edhe ndalimi i eksportit të barnave/pajisjeve mjekësore, deri në 6 muaj.
 - (2) Subjektet apo individët që organizojnë zhvillimin e aktiviteteve publike dhe jopublike, si aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca, apo grumbullimet

masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, dënohen me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për organizatorët dhe ndalimin e aktivitetit.

- (3) Dënohet me gjobë në masën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë:
 - a) Shtetasi, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk deklaron ardhjen e tij nga zonat e prekura nga infeksioni COVID-19, të deklaruara nga organet kompetente, vendase ose të huaja apo ndërkombëtare;
 - b) Shtetasi, i cili hyn nga zonat e prekura në territorin e Republikës së Shqipërisë, që nuk vetëkarantinohet për një periudhë 14-ditore në ambientet e banesës së tij, si një masë parandaluese për mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19;
 - c) Shtetasi, i cili vjen nga zonat e prekura dhe nuk zbaton urdhrin e dhënë nga organet kompetente për vetëkarantinimin e detyrueshëm;
 - d) Shtetasi, i cili ka rezultuar pozitiv dhe nuk zbaton urdhrin e dhënë nga organet kompetente për vetëkarantinimin e detyrueshëm.
- (4) Institucionet arsimore, çerdhet dhe kopshtet, publike dhe jopublike, që nuk mbyllin aktivitetin e tyre për periudhën e përcaktuar nga autoritetet kompetente, dënohen me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për institucionet arsimore, publike/jopublike, dhe në masën 1 000 000 (një milion) lekë për çerdhet dhe kopshtet, publike/jopublike. Në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore.
- (5) Subjektet apo individët, publikë apo privatë, që zhvillojnë aktivitete në ambjentet e mbyllura të argëtimit për fëmijë e të rinj, palestrat, qendrat sportive, pishinat, qendrat e internetit, qendrat kulturore, që nuk zbatojnë urdhrin e organit kompetent për mbylljen e tyre, dënohen me gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë, dhe në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore.
- (6) Subjektet apo individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrat e dhëna nga organet kompetente për mosmbylljen e bareve, lokaleve, restoranteve dhe klubeve, dënohen me gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë dhe në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e aktivitetit për një periudhë 6-mujore.
- (7) Drejtuesit e automjeteve, të cilët nuk zbatojnë ndalimin e qarkullimit të mjeteve të transportit, publik dhe privat, përfshirë automjetet private, në zonat dhe oraret e

përcaktuara nga organet kompetente, dënohen me heqje të lejes së drejtimit për një periudhë trevjeçare dhe me bllokim të mjetit. Nga ky rregull përjashtohen personat e autorizuar nga organet kompetente.

- (8) Rritja e çmimit të shitjes të të gjitha mallrave dhe produkteve ushqimore, barnave, pajisjeve mjekësore dhe shërbimeve, në krahasim me çmimin e tyre në shitje të rregullt, të tregtuar në muajt paraardhës nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ, dhe për produktet sezonale, sipas çmimit të tregtuar në të njëjtën periudhë kohore në vitin paraardhës nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ, kur nuk vjen si pasojë e rritjes së çmimit nga importi i tyre, dënohet me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për tregtuesit me shumicë dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për tregtuesit me pakicë. Në rast përsëritjeje iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë për një periudhë 6-mujore.
- (9) Mos-ofrimi i shërbimeve nga farmacitë, tregtuesit me shumicë të barnave dhe prodhuesit e barnave, duke zbatuar kriteret e sigurisë të përcaktuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për tregtuesit me shumicë dhe në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tregtuesit me pakicë. Në rast përsëritjeje me bllokimin e të gjithë sasisë së mallit dhe mbylljen e veprimtarisë për një periudhë tre vjeçare.
- (10) Mos-ofrimi i shërbimeve nga subjektet/individët që tregtojnë produkte ushqimore, me shumicë apo pakicë, duke zbatuar kriteret e sigurisë të përcaktuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për tregtuesit me shumicë dhe në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tregtuesit me pakicë. Në rast përsëritjeje me bllokimin e të gjithë sasisë së mallit dhe mbylljen e veprimtarisë për një periudhë trevjeçare.

Për përmbajtjen e plotë të aktit kliko [këtu](#).

4. AKT NORMATIV Nr.4, DATË 16.3.2020 PËR DISA SHITESA NË AKTIN NORMATIV NR.3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”- Fletore Zyrtare Nr. 38/2020

- Me anë të këtij akti normativ u vendosën masa administrative shtesë ndaj atyre të vendosura në Aktin Normativ nr.3 dhe konkretisht:
 - (1) Individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrin e dhënë nga organet kompetente për ndalimin e lëvizjes për këmbësorët sipas orareve të përcaktuara, dënohen me gjobë në masën 10 000 (dhjetëmijë) lekë dhe me bllokim 3 muaj të automjetit privat, nëse e disponon një të tillë.
 - (2) Individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrin e dhënë nga organet kompetente për kufizimin e lëvizjeve në parqe dhe zona të gjelbërta të hapura, në zonat urbane, apo mjedise të tjera publike të hapura, dënohen me gjobë në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë dhe me bllokim 3 muaj të automjetit privat, nëse e disponon një të tillë.
 - (3) Për individët, të cilët, në kushtet e shkeljeve të mësipërme lëvizin me biçikletë, ciklomotor ose motomjet, zbatohet edhe masa shoqëruese e bllokimit të mjetit lëvizës për 3 muaj.

Për përmbajtjen e plotë të aktit kliko [këtu](#).

5. AKTI NORMATIV Nr.8, DATË 24.3.2020 PËR DISA SHTESA NË AKTIN NORMATIV NR.3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”- Fletore Zyrtare Nr. 48/2020

- Me anë të këtij akti normativ u vendosën masa administrative të tjera shtesë ndaj atyre të vendosura në Aktin Normativ nr.3 dhe Aktin Normativ nr.4. Më kryesoret janë:
 - (1) **Të gjitha subjektet që tregtojnë produkte ushqimore dhe produkte të tjera**, me shumicë, të domosdoshme për përballimin e situatës së epidemisë, janë të detyruar të marrin masa për mbajtjen e rezervave që tregtojnë për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së shkaktuar nga infeksioni COVID-19.
 - (2) **Të gjitha subjektet që tregtojnë me shumicë barna/pajisje mjekësore**, subjekte që prodhojnë barna dhe pajisje mjekësore dhe subjektet që ofrojnë shërbime shëndetësore, të jenë në gadishmëri dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar furnizime

me barna dhe pajisje mjekësore dhe për të ofruar shërbime shëndetësore të nevojshme, në kuadër të përballimit të situatës së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19.

(3) Mosmarrja e masave si më sipër nga ana e subjekteve dënohet me:

- i. gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë dhe
- ii. me përjashtimin nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 3-vjeçare nga Agjencia e Prokurimit Publik

Për përmbajtjen e plotë të aktit kliko [këtu](#).

KONTRATAT E PASTRIMIT DHE TRANSPORTIT PUBLIK

6. AKT NORMATIV Nr. 5, DATË 17.3.2020 PËR NJË SHITESË NË AKTIN NORMATIV NR.3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUdhËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”, TË NDRYSHUAR- Fletore Zyrtare Nr. 40/2020

- Me anë të këtij akti normativ u parashikua mundësia për njësitë e vetëqeverisjes vendore që të amendojnë kontratat e pastrimit dhe transportit publik gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Konkretisht në këtë Akt Normativ parashikohet se: *Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në kuadër të marrjes së masave gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, me pëlqimin e operatorëve ekonomikë, mund të bëjnë amendime të kontratave që kanë me operatorët e pastrimit dhe operatorët e transportit publik për ofrimin e këtyre shërbimeve, sipas nevojave të diktuar nga situata emergjente. Kontrata hyn në fuqi pas miratimit nga këshilli bashkiak përkatës. Kontrata nënshkruhet nga titullari i autoritetit kontraktor. Shpenzimet do të përballohen nga buxheti i njësisë të vetëqeverisjes vendore.*

KOHËZGJATJA E PUNËS NË INSTITUCIONET SHETËRORË

7. VENDIM Nr.237, DATË 20.3.2020 PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË INSTITUCIONET SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR- Fletore Zyrtare Nr. 44/2020

- Me anë të kësaj VKM u përcaktua orari i punës për nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë të administratës publike/shtetërore nga ora 08:00 deri në 13:00, për të gjithë periudhën e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
- Nëpunësit civilë dhe punonjësit e përmendur VKM Nr.237, ngarkohen të kryejnë çdo detyrë funksionale që iu ngarkohet nga eprori i drejtpërdrejtë apo titullari i institucionit, e cila mund të përmbushet në kushtet e banesës, nëpërmjet komunikimit telefonik apo të mënyrave të tjera të komunikimit elektronik.

Për përmbajtjen e plotë të aktit kliko [këtu](#).

ORARET E LËVIZJES DHE KUFIZIME TË TJERA

8. URDHËR Nr. 193, DATË 20.3.2020 “PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” - Fletore Zyrtare Nr. 34/2020

Me anë të këtij urdhëri të nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është vendosur:

- Të lejohen të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në fashën orare 05:00-13:00, duke filluar nga dita e hënë datë 23.03.2020, pikat e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë dhe shumicë, pikat e tregëtisë së barnave, produkteve mjekësore dhe institucioneve financiare.
- Kufizimi i lëvizjes në të gjitha qendrat urbane, për të gjitha kategoritë (këmbësor, biçikleta, çiklomotor, motomjete dhe mjete), duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë datë 21.03.2020 deri në orën 05:00 të datës 23.03.2020. Përfshihen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitë kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike si edhe shërbimet në banesë (delivery)
- Të ndalohet ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitetet përfshirë ato të përcaktuara më lartë si edhe të përcaktuara në Tabelën 1 duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë datë

21.03.2020 deri në orën 05:00 datë 23.03.2020. Lista me aktivitetet e përcaktuara në Tabelën 1 hyn në fuqi në orën 05:00 të datës 24.03.2020.

- Punonjësit e institucioneve financiare, të linjave prodhuese dhe ushqimore dhe të gjitha aktivitetet e lejuara, sipas Tabelës 1, do të lejohen të qarkullojnë vetëm në itinerarin shtëpi-punë.

Për përmbajtjen e plotë të aktit kliko [këtu](#).

9. URDHËR Nr. 131, DATË 8.3.2020 “PËR NDALIMIN E EKSPORTIT TË BARNAVE DHE TË PAJISJEVE MJEKËSORE”- Fletore Zyrtare Nr. 34/2020

- Me anë të këtij urdhëri të nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është vendosur:
 - (1) Ndalimi i eksportit të barnave dhe të pajisjeve mjekësore nga Republika e Shqipërisë deri në një urdhër të dytë.
 - (2) Eksporti i barnave dhe i pajisjeve mjekësore do të kryhet vetëm me autorizim të posaçëm të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Për përmbajtjen e plotë të aktit kliko [këtu](#).

10. URDHËR NR.156, DATË 10.03.2020 PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NË PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19

- Me anë të këtij urdhëri të nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është vendosur midis të tjerave:
 - (1) **Mbyllja për publikun deri në datë 03/04/2020 të:**
 - a) Ambjenteve që ofrojnë shërbime në lokale nate
 - b) Ambjenteve të mbyllura të dedikuara për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjtë, aktivitetëve në palestra, qendra sportive, pishina, qendra internet, qendra kulturore dhe argëtimi
 - (2) **Ndalimi deri në datë 03/04/2020 të:**
 - a) Aktiviteteve sportive, sociale dhe kulturore;

- b) Ekskursioneve mësimore të organizuara prej institucioneve shkollore me destinacion brenda ose jashtë vendit;
 - c) Procedurave të konkursit për punësim personeli, konkurse shkollimi dhe specializimi.
- (3) **Institucionet publike dhe private, të hartojnë sipas fushës së përgjegjësisë së tyre brenda datës 11.03.2020 një plan masash për sigurimin e ofrimit të shërbimeve prioritare**, duke prioritetizuar kategoritë e shërbimit kryesisht nëpërmjet ofrimit të shërbimit online, punës në distancë, dhe vetëm në raste të domosdoshme të ofrojnë shërbimin ndërmjet kontaktit fizik. Për shërbimet për të cilat nevojitet kontakti i drejtpërdrejtë me publikun institucionet duhet të pajisin personelin me mjete pune mbrojtëse me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre.

Për përmbajtjen e plotë të aktit kliko [këtu](#).

11. URDHËR NR.164, DATË 12.03.2020 PËR MBYLLJEN E BAREVE, RESTORANTEVE, LOKALEVE, FAST FOOD DHE KUFIZIMIN E SHËRBIMEVE QË OFROHEN NGA STRUKTURAT AKOMODUESE QË OFROJNË SHËRBIM PËR KLIENTËT

- o Me anë të këtij urdhëri të nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë vendosur disa detyrime për bizneset në fushën e shërbimeve dhe strukturave akomoduese. Detyrimet kryesore të parashikuara janë:
 - (1) Mbyllja e bareve, restoranteve, fast food, lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët, në të gjithë vendin deri në datën 03.04.2020. Përfshirë nga ky rregull bëhet vetëm për shërbimin në banesë (delivery);
 - (2) Përdorimi i shërbimit të bareve dhe restorante në strukturat akomoduese vetëm për qytetarët e akomoduar në këto struktura deri në datën 03.04.2020.

Për përmbajtjen e plotë të aktit kliko [këtu](#).

IV. VENDIME DHE NJOFTIME TË TJERA TË RËNDËSISHME NGA ORGANET MBIKËQYRËSE DHE RREGULLATORE

1. VENDIMMARRJA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS I DATËS 12 MARS 2020

Vendimi u krijon lehtësi bankave dhe subjekteve financiare jobanka, si dhe shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre për periudhën mars – maj 2020, që në rastet kur evidentohen paaftësi paguese të kredimarrësve të mos jenë subjekt i zbatimit të kërkesave të këtyre rregulloreve që lidhen kryesisht me klasifikimin dhe krijimin e fondeve për provigjione.

Në mbështetje të ekonomisë shqiptare në kushtet e situatës së krijuar në vend nga përhapja e infeksionit të shkaktuar nga virusi COVID-19, Këshilli Mbiqëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi:

- (1) Miratimin e një ndryshimi në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”
- (2) Miratimin e një ndryshimi në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”
- (3) Miratimin e një ndryshimi në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”

Për përmbajtjen e plotë të aktit kliko [këtu](#).

2. URDHËR I PËRBASHKËT DATË 17.03.2020 I KRYEMINISTRIT DHE GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR SHTYRJEN ME 3 MUAJ TË AFATIT TË PAGIMIT TË KËSTEVE TË KREDIVE

- (1) Shtyhet afati i pagimit të kësteve të kredive për biznese dhe individë deri në datën 31.05.2020, për të gjithë ata kredimarrës, të cilët janë përballur më vështirësi në këtë periudhë si pasojë e COVID-19;
- (2) Kredimarrësit duhet të komunikojnë me kredidhënësit (banka, institucione financiare jobanka apo me shoqëritë e kursim-kredive) duke u argumentuar këtyre të fundit arsyet mbi nevojat e tyre për shtyrje të pagimit të kësteve.

- (1) Institucionet e kreditimit do të bëjnë procesimin e çdo kërkesë të paraqitur pranë tyre brenda 3 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

3. NJOFTIM I MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR DENONCIMIN E PRAKTIKAVE ABUZIVE NGA TREGËTARËT

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të masave të marra nga qeveria për parandalimin e përhapjes së Covid-19, si dhe në kushtet e ndalimqarkullimit, përmes strukturave të saj po monitoron sjelljen e tregjeve për të shmangur çdo abuzim të mundshëm nga tregtarët. Për këtë qëllim është në dispozicion edhe numri i gjelbër pa pagesë 0800 14 14, ku të gjithë mund të bëjnë denoncime të rasteve që konstatojnë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë inkurajon qytetarët që të përdorin këtë mjet komunikimi, për të ndihmuar në evidentimin e rasteve, të cilat do të ndiqen me prioritet, bazuar kjo edhe në ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorit” i cili përcakton ndalimin e praktikave të padrejta tregtare, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, nuk përbëjnë vepër penale, por kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me penalitetet përkatëse në fuqi.

Për përmbajtjen e plotë të njoftimit kliko [këtu](#).

4. NJOFTIME TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

- (1) Informacion mbi mundësinë e pagesës së detyrimeve tatimore nëpërmjet portalit e-albania si dhe online-banking në bankat e nivelit të dytë;
- (2) Mbi procedurën që duhet ndjekur për autorizimin e qarkullimit të punonjësve të kompanive dhe sipërmarrjeve të prodhimit;
- (3) Lista e aktiviteteve që do të lejohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe aktivitetet të cilat do të ndalohen të ushtrojnë aktivitetin ekonomik duke filluar nga data 24 Mars 2020.

Për të parë përmbajtjen e plotë të njoftimeve klikoni lidhjet e mëposhtme:

- <https://www.tatime.gov.al/d/8/45/45/1278/njoftim-pr-qarkullimin-e-punonjsve-t-kompanive-dhe-siprmarrjeve-t-shrbimit-q-jan-t-lejuara-t-ushtrojn-aktivitetin>

- <https://www.tatime.gov.al/d/8/45/45/1282/lista-e-aktiviteteve-qe-do-te-lejohen-te-ushtrojne-aktivitetin-e-tyre-dhe-aktivitetet-te-cilat-do-te-ndalohen-te-ushtrojne-aktivitetin-ekonomik-duke-filluar-nga-data-24-mars-2020>

5. NJOFTIM I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME LIDHUR ME AFATIN E QËNDRIMIT TË SHTETASVE SHQIPTARË NË ITALI DHE DHE REPUBLIKËN ÇEKE

- Duke nisur nga data 2 mars 2020, është vendosur një pezullim 30 ditor i afateve për procedimet administrative lidhur me qëndrimin e shtetasve të huaj, në territorin italian. Pezullimi, vlen si për procedurat e lidhura me lejet e qëndrimit (aplikim i parë ose rinovim), ashtu edhe për vizat. Për këtë arsye, bën me dije MEPJ, nuk do u jepet masa e përjashtimit nga territori italian qytetarëve të huaj, të cilët do të gjendeshin në situatë parregullsie, të shkaktuar nga pezullimi i korridoreve të transportit të qytetarëve me Republikën e Italisë. Gjithashtu, sa i përket qëndrimit të qytetarëve shqiptarë në Republikën Çeke, MEPJ informon se të gjithë shtetasit e huaj, të cilët në momentin e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, ndodheshin në mënyrë legale në territorin çek, do të mund të vazhdojnë të qëndrojnë në këtë territor gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme, pa pasur nevojë të zgjidhin çështjet e statusit të qëndrimit të tyre.

Për përmbajtjen e plotë të njoftimit kliko [këtu](#).

6. NJOFTIM I MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

- Me anë të këtij njoftimi bëhet me dije se kompanitë e transportit ndërkombëtar të mallrave të dorëzojnë emrat e drejtuesve të automjeteve. Në kuadër të organizmit të transportit ndërkombëtar të mallrave, si pasojë e masave të marra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, kërkohet nga të gjitha kompanitë të cilat kryejnë transport ndërkombëtar të mallrave që brenda ditës së sotme, 14.03.2020, ora 23:00 të dorëzojnë në adresën e email transporti@infrastruktura.gov.al, listën e drejtuesve të automjeteve, të cilët kryejnë transport ndërkombëtar”, thuhet në një njoftim të shpërndarë sot nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo listë duhet të përmbajë emër, atësi, mbiemër, ditëlindje, numër pasaporte dhe numrin e lejes së drejtimit ndërkombëtare. Nga ana e autoriteteve do të lejohen të qarkullojnë vetëm kompanitë të cilat do të dërgojnë emrat e drejtuesve të tyre.

Për përmbajtjen e plotë të njoftimit kliko [këtu](#).

7. NJOFTIM I MINISTRISË SË BRENDSHME PËR PEZULLIMIN E APLIKIMEVE PËR DOKUMENTE BIOMETRIKE DHE PRITJA E QYTETARËVE NË ZYRAT E SHËRBIMIT PËRJASHTO KALLËZIMET NË POLICI

Në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19:

- (1) Ndalohen të gjitha pritjet e qytetarëve në sportelet e shërbimeve në të gjitha institucionet e sistemit të Ministrisë së Brendshme, deri në një njoftim të dytë. Telefono MB – 0694134779
- (2) Përfshihen nga ky ndalim vetëm rastet e kallëzimeve që qytetarët bëjnë pranë strukturave të Policisë së Shtetit. Sugjerohet edhe në këto raste kallëzimet të bëhen me shkrim. Telefono 112 ose denonco në Komisariatit Dixhital
- (3) Pezullohet aplikimi i qytetarëve për karta identiteti dhe pasaporta deri në datë 03.04.2020.
- (4) Të gjithë aplikimet, kërkesat apo ankesat e qytetarëve do të pranohen vetëm në rrugë elektronike në adresat e institucioneve përkatëse.


Për përmbajtjen e plotë të njoftimit kliko [këtu](#).

8. NJOFTIM I POLICISË SË SHETIT NË LIDHJE ME VETËDEKLARIMIN E LËVIZJES ME MJET- "COVID-19" - VETËDEKLARO LËVIZJEN ME MJET

- Përmes këtij vetëdeklarimi online, autorizoheni për të lëvizur për punë (vajtje-ardhje) me automjetin tuaj, për rastet kur nuk ka transport nga firma ku punoni, duke respektuar oraret: 06:00-08:00 dhe 16:00-17:00. Për mjetet 4+1, lejohen deri në 3 persona në mjet, ku personat duhet të pajisen me masat mbrojtëse të nevojshme (maska, doreza, dezinfektant), mjeti të dezinfektohet vazhdimisht, dritaret e mjetit të qëndrojnë pakëz hapur për të lejuar qarkullimin e ajrit! Për motomjetet, lejohet vetëm 1-person i cili duhet të jetë i pajisur me kaskë dhe maskë mbrojtëse! Shënim: Për lejimin e qarkullimit përtej orareve të sipërcituara, duhet autorizim i veçantë nga organet e Policisë së Shtetit.

Për përmbajtjen e plotë të njoftimit kliko [këtu](#).

Kjo përmbledhje përmban informacion të përgjithshëm të marrë nga ligje, akte nën-ligjore apo dokumenta të tjera pjesë e domain-it publik. Informacioni i përfshirë në këtë përmbledhje nuk është shterues dhe nuk zëvendëson asistencën apo këshillimin profesional që mund t'ju duhet ju apo institucioneve përkatëse. Asnjë pjesë e këtyre faqeve, qoftë tekst apo imazh nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të përcaktuar. Këshilli i Investimeve është një platformë e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e BERZH-it për të rritur dialogun midis qeverisë dhe sektorit privat, për të përmirësuar klimën e biznesit dhe për të nxitur qeverisjen e mirë. Puna e Këshillit mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit. Financimi aktual për Sekretariatit ofrohet nga Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).



Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO)